



Kompania Rajonale e Ujësjesit

*Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija*

Kompania Rajonale e Ujësjesit Gjakova, Sh.A , duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/ 2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall :

K O N K U R S

Titulli I vendit të punës - Punëtor Fizik (NJO-Rekë e Keqe)

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ Puna Provuase gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :

- Punon në gropimin e kanaleve dhe pastrimin e tyre gjatë eliminimit të defekteve;
- Punon në ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të ndryshme,
- Benë pastrimin e objekteve, kanaleve dhe pjesëve tjera,
- Ndhmon punëtorëve të KV gjatë eliminimit të defekteve,
- I zbaton masat e mbrojtjes në punë dhe masave higjienoteknike,
- Punon dhe punë të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.

- Përgatitja profesionale/Shkollore- Shkolla fillore/mesme
- Preferohet përvoja e punës 1 vjeçare që ndërlidhet me punën
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe fizike në kryerjen e detyrave të punëtorit fizik
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime

Paga mujore: Sipas Rregullores

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim- Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3. CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit(kopja e noterizuar), përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkurrimit është nga data: 23/12/2020 deri me 06/01/2021. Adresa e zyrës Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë- Kosovë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara me postë, të clat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.